

MENDIM PARALEL

1. Unë, komisioneria Valbona Sanxhaktari, në cilësinë e anëtarit (kryesues) të trupit gjykues, kam ndarë mendim paralel ndaj arsyetimit të shumicës, në vendimin nr. 578 datë 22.11.2022 ndaj subjektit rivlerësues znj. Teuta Hoxha, lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor e atij nënligjor në tërësi të rivlerësimit kalimtar të subjekteve rivlerësues.

2. Gjatë verifikimit dhe kontrollit të pasurive normalisht është vijuar me kontrollin e pasurisë **apartament me sip. 91 m², në rrugën “****”, Tiranë, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit nga viti 2001**, e në vijim është konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e gërmës “c” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklaratimet e saj i gjejnë sipas pikës 5 të nenit “D” të aneksit të Kushtetutës.

3. Në vijim është vlerësuar pasuria **apartament me sip. 57 m², në G., Kavajë**, deklaruar në deklaratën veting, blerë sipas aktmarrëveshjes datë 21.4.2007, në vlerën 2.100.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar e krijuar me të ardhura e krijuara nga puna në vitet 2005 dhe 2006. Gjatë hetimeve subjekti rivlerësimit ka deklaruar se vlera e paguar në çastin e nënshkrimit të kontratës ka qenë 700.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër është kompensuar me shërbime ligjore. Lidhur me këtë pasuri është konkluduar se subjekti i rivlerësimit, ndodhet në situatën ligjore të parashikuara nga pikat 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 84/2016 duke rezultuar në pamundësi financiare në vlerën -2.100.000 lekë.

4. Më tej është vlerësuar pasuria **zyrë me sip. 74.5 m², në bulevardin “****”, Tiranë**, krijuar me Kontratë Premtim Shitje nr. ***, datë 15.6.2008, me vlerë 8.940.000 lekë. Burimi i krijimit i deklaruar për këtë pasuri janë: (i) të ardhurat nga puna e bashkëshortit për vitet 2006, 2007 dhe 2008; (ii) gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortit në vlerën 9.000 euro; (iii) gjendje *cash* krijuar nga të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, paguar nëpërmjet derdhjes në bankë në llogari të bashkëshortit, në shumën 21.000 euro; (iv) huamarrje në shumën 10.000 euro, veprimi nëpërmjet bankës, datë 30.5.2008, me huadhënës K. Ç.; (v) huamarrje në shumat 21.000 USD dhe 13.800 euro (në total 25.000 euro), me huadhënës A. K.; si dhe (vi) huadhënie në shumën 7.980 GBP (afërsisht 10.000 euro), me huadhënës A. M.. Nga analizimi i kësaj pasurie ka rezultuar se ajo është krijuar me hua të marra nga disa huadhënës dhe kursime familjare. Lidhur me këtë pasuri është konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur bashkëshorti i saj, nuk arritën të provonin burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën -6.355.782 lekë, duke e vendosur subjektin në kushtet e pikës 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës si dhe neni 33, pika 5, gërma “b” e ligjit nr. 84/2016.

5. Lidhur me këtë vlerësim të trupit gjykues, unë kam një qëndrim ndryshe. Nga vlerësimi tërësor i pasurive të deklaruar dhe analizuara nga Komisioni subjekti rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare dhe ndodhet në kushtet e gërmës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi huadhënësit e deklaruar prej saj nuk kanë rezultuar me mundësi financiare të mjaftueshme për dhënie e huave e vlerësuar kjo edhe në raport me pikëpyetjet e ngritura gjatë procesit se këto hadhënie ishin jo shumë të qarta dhe korrekte lidhur me dokumentimin (bindjen) e ekzistencës së tyre. Në këtë këndvështrim jam dakord me qëndrimin e shumicës lidhur me problematikat e konstatuara se subjekti ka dështuar të provojë mundësitë financiare

me burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Por në vlerësimin tim, analiza financiare e Komisionit duhet të shtrohej në një mënyrë tjetër, lidhur me vetë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj ndër vite dhe përdorimit të këtyre të ardhurave për krijimin e pasurive. Konkretisht të ardhurat e viteve 2005-2006-2007 duhet të ishin përfshirë në analizën financiare për krijimin e pasurisë **apartament me sip. 57 m², në G., Kavajë**, deklaruar e blerë sipas aktmarrëveshjes datë 21.4.2007. Kjo pasuri rezulton e krijuar më para në kohë, se pasuria **zyrë me sip. 74.5 m², në bulevardin “****”, Tiranë**, krijuar me Kontratë Premtim Shitje nr. ****, datë 15.6.2008.

Analiza e bërë në këtë këndvështrim do të krijonte një situatë të ndryshme financiare e cila në vlerësimin tim do të ishte me e drejtë dhe proporcionale për subjektin e rivlerësimit në raport me procesin e saj rivlerësues. Po ashtu kjo analizë ka edhe një logjikë më të arsyeshme përsakohë vetë pasuria apartament në golem është krijuar në fillim të vitit 2007 e deklaruar me të ardhura dhe kursime të vitit 2005-2006 dhe sigurisht dhe ato të vitit 2007 deri në momentin e krijimit. Mospërfshirja e të ardhurave të familjes në krijimin e kësaj pasurie duke i përfshirë ato në pasurinë tjetër, zyrë në ****, pasuri e krijuar në qershor të vitit 2008, e çmoj si një situatë financiare rënduese në vlerësimin e subjektit, e cila krijon balanca negative të cilat të vlerësuara veçmas nuk janë proporcionale dhe krijojnë rezultate të ndryshme.

6. Në përfundim vlerësoj se subjekti rivlerësimit ka dështuar në përmbushjen e detyrimit të saj sipas nenit 32 pika 4 të igjit nr.84/2016, pasi nuk ka mundur të justifikojë plotësisht dhe bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive në përdorim dhe atyre në pronësi.

Valbona Sanxhaktari

Komisioner